



PROKURORIA THEMELORE GJAKOVË

BULETINI

Janar – Mars 2024



Përmes këtij buletini pasqyrohen aktivitetet kryesore, të cilat janë realizuar në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, për periudhën kohore Janar-Mars 2024

Kryeprokurori Enis Gashi, priti në takim Asistenten Ekzekutive të Zyrës së Prokurorit të Shteteve të Bashkuara për Qarkun Verior të Ilionis, znj. Meghan Morrissey dhe përfaqësues nga Ambasada e SHBA-së në Kosovë

Gjakovë, 24 Janar 2024 – Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore Gjakovë, z. Enis Gashi, ka pritur në takim Asistenten Ekzekutive të Zyrës së Prokurorit të Shteteve të Bashkuara për Qarkun Verior të Ilionis, znj. Meghan Morrissey, Këshilltarin Rezident Ligjor në Ambasadën e SHBA-së në Kosovë, z. Erin Cox dhe Specialisten e Lartë Ligjore në OPDAT, znj. Benina Kusari.

Gjatë këtij takimi Kryeprokurori Gashi, me të pranishmit ka diskutuar për menaxhimin dhe performancën e prokurisë, për sfidat dhe arritjet e prokurorisë, trajtimi i rasteve të dhunës në familje, rastet e veprave penale kundër integritetit seksual, duke u ndërlidhur me nevojat për trajnime shtesë për prokuror, në lidhje me veprat penale të ndryshme me qëllim të avancimit në hetime dhe zgjidhjen e rasteve dhe rekomandimet të cilat synojnë ta avancojnë punën e kësaj prokurorie.

Kryeprokurori ka falënderuar znj. Meghan Morrissey, fillimisht që ka ndarë përvojën dhe eksperiencën e saj lidhur me shkathtësitë në lidërshtipin, si dhe për vizitën, duke vlerësuar përkrahjen e vazhdueshme të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në sundimin e ligjit.



Vizita e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së z. Sami Istrefi në Prokurorinë Themelore në Gjakovë

Gjakovë, 31 janar 2024, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, zhvilloi një vizitë zyrtare në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, ku u prit nga Kryeprokurori, z. Enis Gashi, administratorja dhe stafi i kësaj prokurorie.

Gjatë këtij takimi, z. Istrefi diskutoi me përfaqësuesit e prokurorisë mbi sfidat dhe kushtet për një punë më të mirë dhe rritjen e efikasitetit të shërbimeve që ofron administrata.

Takimi u përqendrua në ndërtimin e një qasjeje të re dhe proaktive nëpërmjet fuqizimit të komunikimit të brendshëm institucional, si një mekanizëm thelbësor për tejkalimin e sfidave të përbashkëta. z. Istrefi theksoi rëndësinë e rritjes së dinamikës së punës, përmirësimit të kushteve të punës dhe avancimin e njohurive të stafit nëpërmjet trajnimeve profesionale. Gjithashtu, u diskutua për forcimin e integritetit, llogaridhënies dhe transparencës në të gjitha proceset administrative.

Drejtori z. Istrefi vuri në dukje nevojën për zbatimin e parimit të meritokracisë, objektivitetit dhe profesionalizmit gjatë proceseve të vlerësimit, ngritjes në detyrë dhe rekrutimit të stafit.



Kërkesë për paraburgim ndaj një të pandehuri për veprën penale trafikim me njerëz

Gjakovë, 1 shkurt 2024 – Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda, ka marr aktvendim për fillimin e hetimeve dhe ka paraqitur kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditësh, ndaj të pandehurit me inicialet A.P.

Sipas kërkesës së Prokurorisë, i pandehuri A.P., merr pjesë në trafikimin me njerëz me anë të kanosjes, përdorimit të forcës, mënyrës së përfitimit përmes punës së detyruar dhe veprime të tjera të dhunshme, kontrolluese të përcjella me maltretimin fizik dhe psikik me qëllim shfrytëzimi për përfitim ndaj të dëmtuarës A.V .

Me çka ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale “Trafikimi me njerëz” nga neni 165 par.1 të KPRK-së.

Kërkesë për paraburgim ndaj një të pandehuri për veprat penale mashtrimi dhe shantazhi

Gjakovë, 1 shkurt 2024 – Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, ka kërkuar caktimin e masës së paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditësh nga Gjykata Themelore në Gjakovë, ndaj të pandehurit me inicialet A.B.

Sipas kërkesës së Prokurorisë, i pandehuri A.B., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore përmes paraqitjes së rreme të fakteve, e mashtron dhe e vë në lajthim personin tjetër, duke e nxitur të veprojë në dëm të pasurisë së saj dhe atë të dëmtuarën A.H., në atë mënyrë që pasi e dëmtuara e kishte vajzën e sëmure, e njëjta bie në kontakt me të pandehurin dhe prezantohet si person me aftësi fetare shëruese.

Në emër të këtij shërimi e dëmtuara i dërgon vazhdimisht të holla përmes agjencionit të transfereve në shumën prej 10,000.00 Franga.

Gjithashtu i pandehuri me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, e kanos personin, se do të zbulojë lidhjen e tyre jashtëmartesore, dhe për këtë i kërkon të holla duke e tërhequr pensionin e Zvicrës dhe të ja sjell të pandehurit.

Kur e dëmtuara kupton se është viktimë e mashtrimit dhe refuzon t'i dërgojë më të holla, i pandehuri, me llogari falso, i dërgon të gjitha fotot dhe videot bashkëshortit të saj, përmes rrjetit social Facebook.

Këto veprime formojnë dyshimin se i pandehuri ka kryer veprat penale “Mashtrimi” nga neni 323 paragrafi 1 i KPRK-së, si dhe veprën penale “Shantazhi” nga neni 329 paragrafi 2 i KPRK-së.

Aktakuzë kundër dy personave për veprat penale vrasje e rëndë, vrasje e rëndë në shtytje dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve

Gjakovë, 1 shkurt 2024 – Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë, kundër të pandehurit të parë: E.S për veprat penale “Vrasja e Rëndë” nga neni 173 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5 të KPRK-së, dhe për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve”, nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së, ndërsa për të pandehurin e dytë E.S., për veprën penale “Vrasje e Rëndë në Shtytje”, nga neni 173 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5 lidhur me nenin 32 par.1 të KPRK-së.

Sipas aktakuzës ndër tjera cekët se i pandehuri i parë E.S., me dt.19.09.2023 në Rahovec, me dashje ka privuar nga jeta, viktimën N.V., dhe po ashtu me dashje vë në rrezik jetën e të dëmtuarit L.V., në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri i parë me armën e tipit revolen SUB Elite 9 mm, shtënë katër here në drejtim të të dëmtuarve, ku si pasoj e plagëve të marra ndërron jetë tani i ndjeri N.V., në QKUK në Prishtinë, ndërsa të dëmtuarit L.V., i shkakton lëndime të rënda trupore.

Po ashtu sipas aktakuzës ndër tjera cekët se i pandehuri i dytë E.S., me dt.19.09.2023 në Rahovec, me dashje ka shtyrë djalën e tij të pandehurin e parë E.S., për kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë, tani të ndjerit N.V., duke vë në rrezik edhe jetën e të dëmtuarit L.V.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që të pandehurit ti shpallë fajtor dhe të dënohen sipas ligjit për veprat penale të cilat ju vihen në barrë.

Aktakuzë kundër një personi për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar

Gjakovë, 2 shkurt 2024 – Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë, kundër të pandehurit N.A., për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, nga neni 414 paragrafi 1 të KPRK-së.

Sipas aktakuzës, me dt.06.12.2022 në Gjakovë, i pandehuri N.A., në cilësinë e Inspektorit të Punës në Zyrën Rajonale në Gjakovë, keqpërdor detyrën e tij zyrtare duke tejkaluar kompetencat e tij, dhe duke i shkelur seriozisht të drejtat e punësimit të dëmtuarës B.M.,

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe të dënohet sipas ligjit për veprën penale e cila i vihet në barrë, si dhe ti shqiptohet dënimi plotësues – Ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose shërbimin publik.

Kërkohet paraburgim ndaj të pandehurit të ekstraduar nga SHBA, për veprën penale të vrasjes dhe veprën penale, mbajtja pa autorizim të armëve dhe municionit

Gjakovë, 8 shkurt 2024 – Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda, ka marr aktvendim për rifillimin e hetimeve dhe ka paraqitur kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditësh, ndaj të pandehurit me inicialet D.LL.

I njëjti është arrestuar me urdhër arrest ndërkombëtar dhe është ekstraduar nga SHBA në Kosovë, nën dyshimin se me dt. dt.12.07.2003 , ka kryer veprën penale të vrasjes nga neni 30 par.2 pika 3 të LPK -së, si dhe veprën penale mbajtja pa autorizim të armëve dhe municionit nga neni 8 par.8.5 lidhur me par.8.3 të rregullores së UNMIK-ut 2001/7.

Kërkesë për paraburgim ndaj një të pandehuri për veprat penale vjedhje e rëndë dhe falsifikimi i dokumenteve

Gjakovë, 9 shkurt 2024 – Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, ka marr aktvendim për fillimin e hetimeve dhe ka paraqitur kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditësh , ndaj të pandehurit me inicialet J.K.

Sipas kërkesës së Prokurorisë, i pandehuri J.K., me datë 25.12.2023, në parkingun e një qendre tregtare në Malishevë, me thyerje e me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, tjetrit i'a merr pasurinë dhe atë të dëmtuarit E.K., me një mjet thyen xhamin e pasëm të veturës së të dëmtuarit, dhe nga aty merr një çantë ku në të ishte një kulet si dhe dy letërnjoftime të lëshuara nga shteti Gjerman, e një i lëshuar nga shteti i Kosovës.

Në kohë të panjohur e gjerë me dt.07.02.2024 në Malishevë, me dije përdor dokumentin e falsifikuar si origjinal dhe atë patentë shoferin si dhe kartën e identitetit, që të dy dokumentet i përdor kinse si origjinale, ku të njëjtat posedojnë të dhënat personale të personit të identifikuar si A.M., ndërsa fotografia e vendosur në ato dokumente është e të pandehurit J.K.

Me këto veprime ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprat penale “Vjedhja e Rëndë” nga neni 315 par.1 nën par.1.1 të KPRK-së, si dhe veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” nga neni 390 par.1 të KPRK-së.

Aktakuzë kundër një personi për veprat penale vrasja dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve

Gjakovë, 12 shkurt 2024 – Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë, kundër të pandehurit I.Z., për veprën penale “Vrasja” nga neni 172 të KPRK-së, dhe për veprën penale “Mbjajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve”, nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

Sipas aktakuzës ndër tjera cekët se i pandehuri I.Z., me dt.20.09.2023 në fshatin Bellanicë, Komuna e Malishevës, me dashje ka privuar nga jeta, tani të ndjerin A.B., në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri derisa ka qenë në lokal, vëren të ndjerin se kishte arritur në parking, i pandehuri afrohet tek automjeti i të ndjerit dhe me armën e tipit revolen SIG SAUER – P320 , shtënë pesë here në kokën e tani të ndjerit, viktimë bie përtokë, i pandehuri vazhdon duke shtënë edhe dy herë prapë në drejtim të tij përderisa trupi ishte i shtrirë për tokë, e ku nga plagët e marra i ndjeri ndërron jetë në vendin e ngjarjes, derisa i pandehuri largohet me veturë e tij nga vendi i ngjarjes dhe lajmërohet në polici.

Po ashtu sipas aktakuzës ndër tjera cekët se i pandehuri I.Z., gjerë me dt.20.09.2023, në fshatin Bellanicë – Komuna e Malishevës, ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armës SIG SAUER – P320 , fishek të kalibrit 9×19 mm, në dy pako, një karikator me 7 fishekë të kalibrit 9×19 mm, me cilën armë ka kryer veprën e përshkruar më lartë, me ç ’rast e njëjta armë dhe municioni janë sekuestruar nga ana e zyrtarëve policor.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe të dënohet sipas ligjit për veprat penale të cilat i vihen në barrë.

Aktakuzë kundër dy personave për veprën penale vjedhje e rëndë në bashkëkryerje në vazhdimësi

Gjakovë, 1 mars 2024 – Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë, kundër të pandehurve Q.L., dhe D.T., për veprën penale “Vjedhje e Rëndë në bashkëkryerje në vazhdimësi” nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 31 e lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Sipas aktakuzës ndër tjera cekët se nga data e pavërtetuar e në vazhdimësi gjerë me dt.23.10.2023, në Gjakovë, saktësisht në depon e objektit afarist pronë e të dëmtuarit M.B., të pandehurit duke vepruar me dashje dhe në bashkëkryerje me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete, e përvetësojnë pasurinë e luajtshme të të dëmtuarit, në atë mënyrë që të pandehurit përmes një vrime rreth 1 metër e hapur në mur në pjesën e pasme të dyqanit kanë kaluar në pjesën e depos që i përket të pandehurit Q.L., ku aty kanë hapur një pjesë të murit ndarës që ka qenë e mbyllur me panele druri me vida të cilat kanë qenë të vendosura nga ana e depos së të pandehurit Q.L., ku kanë hyrë në depon e të dëmtuarit dhe nga aty kane vjedhur mallra të ndryshme të cilat i kanë bartur në dyqanin e të pandehurit Q.L., dhe e kanë mbyllur prapë pjesën e panelit, ku pas një punë operative të policisë një pjesë e sendeve sekuestrohen dhe i kthehen të dëmtuarit, me çka të dëmtuarit i kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm material në shumë prej 94,859.75 Euro.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar gjykatës që të pandehurit të shpallën fajtor dhe të dënohen sipas ligjit për veprën penale e cila ju vihet në barrë.